



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

1 nëntor 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA
Pushteti lokal i Prizrenit sfidon autoritetin e Gjykatës Kushtetuese

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe në pjesën e dytë të shtatorit ka hulumtuar çështjen e zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr. KI 56/09 (http://www.gjks.org/repository/docs/gjk_56_09_shq.pdf), që ka të bëjë me ndërtimin e banesave kolektive në lagjen "Dardania".

Gjatë shqyrtimit të rastit monitoruesit e EC Ma Ndryshe kanë konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr. KI 56/09 nuk është zbatuar në tërësi, si nga komuna e Prizrenit e po ashtu edhe organet përkatëse të gjyqësorit. Si rrjedhojë qytetarët e lagjes "Dardania" edhe pse kanë dal fitues nga një betejë e gjatë ligjore, që ka përfunduar me vendimin e instancës më të lartë për interpretimin e Kushtetutës së Kosovës, ende nuk kanë arritur që të realizojnë të drejtën e tyre, respektivisht të gëzojnë zonën e gjelbër në lagjen e tyre. Në këtë lokalitet vazhdon të qëndroj i paprekur objekti që ishte në ndërtim e sipër nga komuna e Prizrenit, edhe pse në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese theksohet se kjo është në kundërshti me nenin 52.2 të Kushtetutës dhe kërkohet nga KK-ja që brenda gjashtë muajve nga data e shpalljes së aktgjykimit, t'i dorëzohen Kushtetueses informata për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi.

Ndonëse kanë kaluar afër dy vjet nga shpallja e Aktgjykimit të Kushtetueses organet komunale nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim për zbatimin e tij. As institucionet tjera, duke përfshirë edhe gjyqësorin dhe vet Kushtetuesen nuk janë përkujdesur që ky aktgjykim të zbatohet në tërësi, brenda afatit të përshkruar në vet Aktgjykimin e GJK-së. EC Ma Ndryshe konsideron se në këtë mënyrë institucionet publike, të të gjitha pushteteve, kanë injoruar të drejtën e qytetarëve të lagjes "Dardania", të cilët kanë ndjekur të gjitha procedurat dhe në mënyrë institucionale kanë vërtetuar të drejtën e tyre për mbrojtjen e ambientit jetësor.

Rrugëtimi deri në këtë pikë i banorëve të lagjes "Dardania" nuk ka qenë i lehtë, prandaj dhe nuk e meriton një injorim të tillë nga institucionet, që duhet të jenë në shërbim të interesave të qytetarëve.

Komuna injoron të gjitha nismat e banorëve

Banorët e "Dardanisë" iu ankuan KK-së së Prizrenit më 13 korrik 2009 lidhur me Vendimin e 30 prillit 2009, të miratuar pa pjesëmarrje publike, lidhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit të PDU-së të vitit 1983, e që ka të bëjë me ndërtimin e banesave kolektive për rastet sociale dhe familjet e dëshmorëve, që deri atëherë ishte e destinuar për shfrytëzim si hapësirë e gjelbër respektivisht park i lagjes. Banorët kurrë nuk morën përgjigje nga organet komunale në peticionin e tyre të 13 korrikut 2009, ndonëse ishte e nënshkruar nga 393 banorë të lagjes "Dardania". Meqë kërkesa e tyre për anulimin e këtij vendimi u injorua nga KK-ja, atëherë ata iu

drejtuan Avokatit të Popullit, Gjykatës Kushtetuese dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Më 22 tetor 2009, Avokati i Popullit, Sami Kurteshi i shkruan kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, ku e adreson kërkesën urgjente për caktimin e masës së përkohshme për ndërtimin në lagjen "Dardania" në Prizren, "me qëllim të evitimit të dëmeve të riparueshme që mund të paraqiten". Asokohe Avokati i Popullit pat kërkuar nga Krasniqi "që deri në kohën e përfundimit të hetimeve tona si dhe derisa nuk merret ndonjë vendim nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, të ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme, me qëllim të ndërprerjes së punimeve të filluara nga Komuna e Prizrenit, për ndërtimin e banesave të larta në Lagjen "Dardania" në Prizren". Kopja e shkresës i ishte dërguar edhe ish-ministrit të MMPH-së, Mahir Yagcilar dhe kryetarit të komunës së Prizrenit, Ramadan Muja.

Përkundër këtyre nismave ligjore pushteti lokal i Prizrenit i nis punimet për ndërtimin e banesave kolektive për rastet sociale dhe familjet e dëshmorëve. Gjykata Kushtetuese, në dhjetor të vitit 2009 pat pezulluar vendimin e KK-së për 3 muaj, duke urdhëruar pushtetin lokal që të pezullojë çdo ndërtim në këtë lagje. Në fund të muajit mars të 2010-s, Kushtetuesja e pat zgjatur këtë pezullim edhe për 45 ditë. Në maj të 2010-s komuna ka provuar që të organizoj një diskutim publik, por ky debat për ndryshimin dhe plotësimin e planit detal urban të lagjes "Dardania", ku parashihej ndërtimi i objekteve të destinuara për familjet e dëshmorëve dhe rastet sociale, ishte ndërprerë për shkak të përplasjeve mes banorëve të lagjes dhe zyrtarëve të lartë komunalë të Prizrenit. Përfaqësuesit e komunitetit patën kundërshtuar formën e organizimit të takimit, duke shprehur bindjen se në këtë mënyrë zyrtarët komunalë dëshirojnë t'i plotësojnë procedurat e injoruara më parë dhe në këtë mënyrë tentojnë të formalizojnë vendimin e marrë për ndërtimin e banesave kolektive në këtë lagje.

Zbatimi i aktgjykimit vonohet për shumë muaj

Përplasjeve të shumta mes komunitetit të lagjes "Dardania" dhe pushtetit lokal të Prizrenit i vie fundi më 22 dhjetor 2010, kur Gjykata Kushtetuese shpall aktgjykimin në rastin Nr. KI 56/09, përmes të cilit njëzëri konstaton se "ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës të garantuar me Nenin 52(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

Në aktgjykim GJK gjithashtu "Konsideron që Kuvendi Komunal i Prizrenit duhet t'i dorëzojë Gjykatës, brenda gjashtë muajve, informata për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi". Ndonëse kanë kaluar 22 muaj nga ky aktgjykim, organet komunale të Prizrenit nuk i kanë ofruar asnjë informatë GJK-së, rreth zbatimit të tij.

Banorët e lagjes "Dardania" njëherësh parashtruesit e kërkesës në GJK (Fadil Hoxha dhe të tjerët) kanë ndërmarr veprime në raport me komunën e Prizrenit për këtë aktgjykim, por në mungesë të përgjigjes, gjatë këtij viti (në korrik) e kanë informuar GJK-në në lidhje me moszbatimin e aktgjykimit dhe kanë kërkuar ndërmarrjen e veprimeve ligjore.

Ndërsa më 2 tetor 2012 GJK u ka dërguar shkresa të gjitha rasteve për të marrë informata rreth zbatueshmërisë së aktgjykimeve. Afati për përgjigje ka qenë 15 ditë, ndërsa vetëm Komuna e Prizrenit nuk ka kthyer përgjigje. GJK rishtazi ka themeluar Task Forcën për përcjelljen e zbatueshmërisë së aktgjykimeve prej vitit 2009 e deri më sot dhe ka rezultuar se 99 për qind e vendimeve janë zbatuar, me përjashtim të rasteve, Ferizaji 08/09 dhe Prizreni 56/09.

Dështimi i tërë sistemit shtetëror

EC Ma Ndryshe, duke i marrë për bazë të gjitha këto të dhëna, dhe konstatimin e personave përgjegjës se moszbatimi i një aktgjykimi është shkelje e të drejtave të njeriut, ka ardhur në përfundim se në rastin “Dardania” i tërë sistemi shtetëror ka dështuar në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të banorëve të kësaj lagjeje.

Ndonëse në vendim të GJK-së thuhet se KK-ja ka përgjegjësi, në nivel lokal vendimet ekzekutohen nga qeveria komunale, prandaj dhe përgjegjësia bie mbi ekzekutivin dhe legjislativin. Pos Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës së Prizrenit, të cilat kanë pas përgjegjësi direkte edhe institucionet tjera përkatëse mbajnë përgjegjësi për mos zbatimin e vendimit të Kushtetueses, duke sfiduar në mënyrë serioze Kushtetutshmërinë e vendit.

EC Ma Ndryshe vlerëson se ky rast është një shembull i keq për demokracinë e re të Republikës së Kosovës, ku qytetari edhe pse ndjek procedurat nga peticioni në nivel lokal e deri te Gjykata Kushtetuese, nuk mund të gëzojë të drejtat e veta, anipse vendimi i GJK-së dhe Kushtetuta ia garanton një gjë të tillë. Një praktikë e tillë në mënyrë serioze e pasivizon qytetarin e Kosovës dhe ia humb besimin në sundimin e ligjit.

Zbatimi i vendimeve të GJK-së është i detyrueshëm

EC Ma Ndryshe konstaton se neglizhenca e Kryetarit dhe KK-së së Prizrenit kundruall qytetarëve të vet në radhë të parë dhe më pas edhe karshi vendimit të GJK-së është i pajustificueshëm dhe nuk shkon në dobi të qeverisjes së mirë dhe efektive lokale. Vendimet e GJK-së janë përfundimtare, të pakontestuara dhe zbatimi i tyre është i detyrueshëm.

Vendimet e GJK-së kanë detyruar dy presidentë të Kosovës që të largohen nga posti më i lartë shtetëror, prandaj dhe komuna e Prizrenit nuk mund të bëjnë përjashtim në këtë drejtim, por duhet t’i binden interpretimit të GJK-së.

EC Ma Ndryshe ia përkujton MAPL-së se Ligji për Vetëqeverisje Lokale përmban dispozita të qarta për veprime ndaj zyrtarëve dhe organeve komunale në rast se ato dështojnë në kryerjen e funksionit sipas standardeve të përcaktuara me ligj dhe për shkelje të Kushtetutës.

Neni 50.1 dhe dispozitat e nenit 64 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale i parashohin veprimet ligjore dhe institucionale në rast se çënohet Kushtetuta dhe ligjet, dhe institucionet komunale dështojnë në kryerjen e funksionit të paraparë me ligj dhe si rezultat rrezikojnë ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve.

Duke u nisur nga ky rast, EC Ma Ndryshe rekomandon edhe Gjykatën Kushtetuese që në të ardhmen të jetë më aktive sa i përket përcjelljes së zbatueshmërisë së vendimeve të saj dhe të mos vonohet sikurse në rastin “Dardania”.

EC Ma Ndryshe përkujton të gjitha institucionet publike se ato janë shërbim për përmbushjen e detyrave karshi qytetarëve dhe jo për shkeljen e të drejtave të tyre.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012
përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*